

KËRKESË
Nr. 1171, datë 29.6.2020

PËR BOTIMIN E VENDIMIT PËR DËNIM ADMINISTRATIV NDAJ SUBJEKTIT
“INTERCALL ALBANIA”

ISHSH-ja, Dega Rajonale e Qarkut Tiranë, meqenëse ka realizuar njoftimin zyrtar për vendimin përfundimtar të inspektimit, nëpërmjet shërbimit postar është kthyer njoftimi i institucionit tonë (në adresën ku kryen aktivitetet dhe në adresën e pasqyruar në QKB), duke u konfirmuar nga shërbimi postar: objekt i panjohur.

Sa më sipër, ISHSH-ja, Dega Rajonale Qarku Tiranë, duke qenë se Posta Shqiptare e ka të pamundur komunikimin e masës administrative, bën njoftimin publik të vendimit përfundimtar të inspektimit nr. ISHSH TR-2020 001367-5, datë 12.6.2020, për subjektin “InterCall Albania”, me NIPT L71513025Q, me adresë: rruga “Mine Peza”, nr. 13, ZK 8330, Tiranë.

KRYEINSPEKTOR
Areti Beruka

VENDIMI PËRFUNDIMTAR I INSPEKTIMIT

Nr. ISHSH-TR-2020-001395-5
22.6.2020

D a t ë

Bazuar në nenin 46, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, në VKM-në nr. 241, datë 27.3.2013, “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor”, dhe në procesverbalin e inspektimit nr. ISHSH-TR-2020-001395-2, datë 22.6.2020, inspektim që është zhvilluar në subjektin “InterCall Albania”, NIPT L71513025Q, përfaqësues i autorizuar i subjektit z. Gledis Rusi, ID J71219017V, prej datës 22.6.2020 deri më datën 22.6.2020.

Grupi i punës, pasi realizoi inspektimin, e hartoi procesverbalin e inspektimit në datën 22.6.2020 dhe e njoftoi në datën 22.6.2020. Në bazë të procesverbalit të inspektimit dhe të kontestimeve të subjektit të inspektimit, rezultuan këto shkelje të kërkesave ligjore:

Ligji nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe të sëmundjeve infektive”, i ndryshuar, neni 7, pika 4, akt normativ nr. 2, datë 11.3.2020, neni 3, pika “c”.

Për shkak të shkeljeve të konstatuara të kërkesave ligjore të subjektit të inspektimit, në mbështetje të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe të sëmundjeve infektive”, të ndryshuar, neni 7, pika 4, akt normativ nr. 2, datë 11.3.2020, neni 3, pika “c”, neni 3, pika “c”, ato klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënimet administrative si më poshtë:

1. Dënim administrativ kryesor:

Gjobë 100 000 lekë;

2. Dënim administrativ plotësues:

Korrigjimi i shkeljeve të konstatuara dhe eliminimi i pasojave të tyre në një afat kohor të arsyeshëm. Detyra për t'u realizuar me afate kohore respektive:

Shuma e shpenzimeve për përzgjedhjen, transportin dhe ekzaminimin apo analizën e mostrave.



Inspektorët shtetërorë të autorizuar:

Jeta Harizi ID_04010 10008



Reada Gjata ID_0401070001

Personi i autorizuar i subjektit

Gledis Rusi ID_J71219017V



Kundër vendimit përfundimtar të inspektimit, subjekti “InterCall Albania” ka të drejtën e ankimit, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit përfundimtar. Ankimi paraqitet pranë organit epror të Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor. Vendimi përfundimtar mbahet në 4 kopje.